



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

A nr. 271/2013

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Muhamet Rexha kryesues, Hasan Shala dhe Ferit Osmani anëtarë, duke vendosur përkritazi me ankesën e Lëvizjes Vetëvendosje (LVV), dega në Klinë, paraqitur kundër subjektit politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), dega në Klinë, për shkak të vendosjes së baneritë mbi Rrugën Publike, për Zgjedhjet Lokale, në seancën e panelit të mbajtur me 25.10.2013, mori këtë:

VENDIM

Miratohet si e bazuar ankesa e Lëvizjes Vetëvendosja (LVV), dega në Klinë, kështu që subjektit politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), i shqiptohet dënimi më gjorbë në vlerë prej 5550 (pesëmijë e pesëqind e pesëdhjetë) euro, të cilën detyrohet ta paguaj në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditë nga dita e pranimi të këtij vendimi.

Arsyetim

PZAP-i, ka pranuar një ankesë më datën 17.10.2013, nga LVV, dega në Klinë në të cilën ankesë theksohet se subjekti politik PDK me datë 17 tetor 2013 në Rrugën "Abedin Rexha" pranë Postës në Klinë antarë të subjektit politik PDK-së kanë vendosur Banerë të kandidatit për kryetar Komune të Klinës Sokol Bashota mbi Rrugën Publike. Mëtej parashtresë i ankesës thekson se me këtë rast është bërë shkelje e nenit 33 pika b të Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme (LZP) Parashtresë i ankesës ka bashkangjitur një fotografi si dëshmi.

PZAP-i, e informoi subjektin politik PDK në kuptim të nenit 4 paragrafi 3 të Rregullave dhe Procedurave të PZAP-it, më datë 18.10.2013, për ankesën që është bërë ndaj këtij subjekti politik dhe ka kërkuar që të përgjigjet ndaj ankesës deri më datë 19.10.2013, brenda afatit të caktuar, PZAP-i, pranoi përgjigjen e kërkuar nga subjekti politik PDK, në të cilën theksohet se përfaqësuesit që kanë nga tereni, aktivistë të painformuar e kanë bërë një veprim të tillë dhe menjëherë është intervenuar dhe është hequr baneri i kandidatit të subjektit politik PDK. Sipas përgjigjes në ankesë nga subjekti politik PDK kjo ka ndodhur për shkak të mos njohjes së rregullave zgjedhore.

PZAP-i, pasi që shqyrtoi ankesën gjeti se:

Ankesa është e bazuar

Nga fotografit e ofruara si provë të cilat gjenden në shkresat e lëndës shihet qartë se baneri i kandidatit të PDK-së për Kryetar Komune të Klinës është vendosur mbi rrugën publike, gjë që e bënë përgjegjëse subjektin politik PDK për këto veprime të cilat janë në kundërshtim me nenin 4.1 pika b) të Rregullës Zgjedhore 11/2013 dhe nenin 33 pika b) të LZP-së të cilat përcaktojnë veprimet e ndaluara nga ana e subjekteve politike gjatë periudhës së fushatës zgjedhore.

Për përcaktimin e lartësisë së gjobës të vendosur në dispozitiv të këtij vendimi PZAP-i, ka marrë parasysh faktorët në vijim:

- Natyra e shkeljes dhe ndikimit të mundshëm të saj në procesin zgjedhor;
- Shkallën dhe peshën e shkeljes;
- Nëse subjekti politik ka marrë pjesë në zgjedhjet e mëparshme, konsiderohet se kanë qenë të njoftuar me obligimet dhe përgjegjësit gjatë procesit të fushatës;
- Nëse subjekti politik ka bërë shkelje të ligjeve zgjedhore në fuqi në këto zgjedhje apo në zgjedhjet e mëparshme në Kosovë si dhe
- Shumën e fondeve të marra nga subjekti politik prej Buxhetit të Republikës së Kosovës, për zhvillimin e aktiviteteve të lidhura më fushatën zgjedhore.

Pretendimet në përgjigje të ankesës nga subjekti politik PDK, se aktivist të painformuar e kanë bërë një veprim të tillë dhe menjëherë është intervenuar dhe është hequr baneri i kandidatit të subjektit politik PDK, përveç thënieve subjekti politik në fjalë, nuk ka ofruar asnjë dëshmi që ka ndërmarr veprime për evitimin e shkeljes së supozuar, siç kërkohet nga dispozita e nenit 32.6 të LZP-së.

Andaj duke marr parasysh faktorët e cituar më lart për përcaktimin e lartësisë së gjobës PZAP-i vlerëson se subjekti politik PDK në këtë rast ka thyer kodin e mirësjelljes për subjektet politike, mbështetësit e tyre dhe kandidatët, shkelje për të cilën parashihet shqiptimi i dënimit me gjobë. Prandaj në kuptim të nenit 3.2 të Rregullës 01/2012 të PZAP-it dhe nenit 120 paragrafi 1 pika (c) dhe 118.1 të LZP-së, PZAP-i vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia

Anr. 271/2013 më datën 25.10.2013.

Kryesuesi i Panelit
Muhamet Rexha



Këshillë Juridike: PZAP nuk do t'i pranojë kërkesat për ri-apelim, sepse vendimet e tij do të konsiderohen si përfundimtare. Prandaj, siç parashihet në Nenin 118.4 të LZP-së, *ankesa në Gjykatën Supreme të Kosovës mund të paraqitet brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes së vendimit nga PZAP-i, në rast se gjoba e përfshirë është më e lartë sesa pesëmijë (5, 000) Euro ose në rast se çështja prek një të drejtë themelore.*